



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V-të

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 29.

Prishtinë, më 02.11.2015 në orën 9:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Luljeta Gutaj -Veselaj, Rustem Mustafa, Vjosa Osmani, Ilir Deda, Arben Gashi dhe Slllobodan Petroviq.

Munguan: Xhavit Haliti Valdete Bajrami, Time Kadrijaj dhe Kujtim Paçaku.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në një të anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen. Projektligji për Ratifikim i ka vetëm 3 nene. Neni i parë tregon qëllimin e projektligjit, neni i dytë është ratifikimi i marrëveshjes dhe neni i tretë, flet për hyrjen në fuqi. Sot është seanca plenare dhe pritet ratifikimi i MSA-së, ku kërkohen 2/3 e votave. Është marrëveshje ndërkombëtare dhe e rëndësishme së veçantë, duke pasur parasysh se Kosova, për herë të parë, ratifikon një marrëveshje me BE-në. Me këtë marrëveshje, niveli i bashkëpunimit ngritet në një nivel më të lartë të bashkëpunimit dhe ka ndryshime substanciale.

Në vazhdim, hapi diskutimin për ratifikimin e MSA-së.

Ilir Deda, propozoi që Komisioni për Integritet Evropian ta bëjë amendamentimin e titullit të projektligjit. Pra, të quhet "Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërin anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër". Gjithashtu, të reflektohet edhe në nenin 1, te qëllimi i ligjit, sepse në nenin 2 dhe 3, ceket Republika e Kosovës dhe kjo të jetë e harmonizuar në 3 gjuhë, pra t'i shtohet fjala "Republika".

Arben Gashi, tha se pajtohet me propozimin e z.Deda, sepse bëhet fjalë për gjuhën juridike të përdorur për interesa të përbashkëta në Kosovë dhe nuk ndikon në Marrëveshjen e Stabilizim- Asociimit, si dhe nuk ndërhyt në asnjë formë në marrëveshje. Sipas tij, duhet të përdoret gjuha juridike dhe kushtetuese, që është "Republika e Kosovës" edhe në titull të projektligjit dhe në të gjitha nenet ku shkruan "Kosova", të jetë "Republika e Kosovës", kurse në marrëveshje e dimë se është me fusnotë dhe marrëveshja nuk ndryshohet, por vetëm në ligj, i cili është për përdorim të brendshëm, le të figurojë dhe rezultojë "Republika e Kosovës".

Pas diskutimeve të anëtarëve, kryetarja e Komisionit konstatoi se Komisioni, njëzëri, për Kuvendin nxori këtë

REKOMANDIM

Të miratohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërin anë dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.

Amendamenti 1

Në Titullin e projektligjit, para fjalës "**Kosovës**", të shtohet fjala "**Republika e**" dhe ky ndryshim të vlejë në tërë tekstin.

Arsyetimin e raportit me rekomandime e paraqet, deputetja Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 9:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Teuta Sahatqija